



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovac



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **10.07.2024** me fillim në ora **10:15**. Këtë mbledhje e kryesoi Kryesuesi i Komitetit për Komunitete **z. Bajram Morina**.

Kryesuesi: Fillimisht, përvendetje për të gjithë! Faleminderit për praninë tuaj. Përvendetje për përfaqësuesit të KFOR-it, OSBE-së, shefin e ZKKK-së Lendrit Qelin, zyrtarin e Drejtorisë së Shëndetësisë, z. Ardian Rama, anëtarët e komitetit dhe gjithë të pranishmit. Ky është takimi i tretë për vitin 2024, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

R E N D D I T E

- 1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë mbi shërbimet shëndetësore dhe mbështetja me ndihma momentale - subvencionimet për komunitetin joshumicë;**
- 3. Informatë nga stacioni i policisë në Rahovec mbi gjendjen e sigurisë në vendbanimet e komunitetit joshumicë, përfshirë edhe në fshatin Hoçë e Madhe;**
- 4. Raporti 6-mujor i punës së ZKKK-së;**
- 5. Të ndryshme.**

Kryesuesi: Para se të dalim në aprovim të rendit të ditës, fjalën ia jap Skenderit.

Skender Hamza: Faleminderit kryesues, përvendetje për të gjithë këtu! Pika e tretë e rendit të ditës në konsultim me kryesuesin shtyhet për mbledhje e radhës, sepse unë nuk kam qenë në punë dhe sekretaria nuk e ka njoftuar dikë në stacion policor për këtë mbledhje. Nëse pajtoheni, kjo pikë shtyhet për mbledhjen e radhës.

Kryesuesi: Faleminderit! Nëse jeni të pajtimit, rendin e ditës pa pikën e tretë e vendosim në votim! Kush është “për”?... Atëherë, konstatoj që unanimisht është aprovuar rendi i ditës.

- 1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë gjë rrëth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Konstatoj që unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

- 2. Informatë nga Drejtoria e Shëndetësisë mbi shërbimet shëndetësore dhe mbështetja me ndihma momentale - subvencionimet për komunitetin joshumicë;**

Ardian Rama: Faleminderit kryesues! Përvendetje për të gjithë anëtarët e komitetit! Sa i përket informatës lidhur me shërbimet shëndetësore dhe mbështetja me ndihma momentale, ne si Drejtori e Shëndetësisë apo QKMF si institucion nuk bën dallime në ofrimin e shërbimeve të sajë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Shërbimet e llojit: Emergjent, të mjekësisë familjare, vaksinimi, shërbimet diagnostike dhe konsultative, shërbimi i vizitave në shtëpi për gratë shtatzëna dhe për fëmijët 0-3 vjeç dhe shërbimet e kujdesit shtëpiak etj.... Një shërbim i veçantë që bëhet enkas për komunitete është vaksinimi në terren, në lagjen e komuniteteve, që mënyrë që asnjë fëmijë të mos mbetet i pavaksinuar. Sa i përket mbështetjes me ndihma momentale. Kemi pasur kërkesa të shumta,

për 161 persona janë aprovuar, ndërsa prej tyre 10 persona kanë qenë të komunitetit joshumicë. Në drejtorinë tonë, çdo kërkesë që i plotëson kriteteret nga komuniteti joshumicë.

Kryesuesi: Faleminderit z. Ardian! A ka dikush diçka rrëth kësaj pike?... Nëse jo, kalojmë në pikën e radhës.

3. Raporti 6-mujor i punës së ZKKK-së;

Lendrit Qeli: Faleminderit kryesues! I nderuar zv.kryesues, pjesëmarrës, përfaqësues nga OSBE, UNMIK-u, KFOR-i, të nderuar anëtarë të komitetit. Raporti është publik në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit, për periudhën janar-qershori 2024, për angazhimin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim. ZKKK është zyrë e cila momentalisht funksionon në kuadër të kabinetit të kryetarit. Fokusi ynë kryesor është përmirësimi i gjendjes së komunitetit joshumicë në vend, zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme që progresojnë edukativo-arsimor, respektimi i të drejtave të njeriut dhe komuniteteve, riatdheshimin dhe kthimin e qëndrueshëm dhe së fundi migrimin dhe integrimin e të kthyerve. Gjatë kësaj periudhe kemi pasur synim disa objektiva kryesore. Objektiv ka qenë përmirësimi i infrastrukturës në vendbanimet e komunitetit joshumicë, fushata të ndryshme sensibilizuese për arsimin, shëndetësinë, barazinë gjinore, fuqizimin ekonomik dhe mbështetja me start-up biznese. Njëri prej projekteve që bën të ndihemi krenarë zyrën tonë dhe Komunën e Rahovecit është fusha e arsimit dhe fillimi i programit “Qendra Mësimore me Bazë në Komunitet” në shkollën “Gëzim Hamza” – piktori, që është njëra prej shkollave që ka numër më të madh të komunitetit joshumicë. E kemi funksionalizuar programin së bashku me mbështetjen e UNMIK-ut dhe organizatës “Advancing Together”. Në këtë shkollë, bashkë me Komunën e Rahovecit e kemi rregulluar edhe terrenin sportiv që do të shërbejë për të rinjtë dhe të rejet e komunës dhe për të gjitha komunitetet që jetojnë në lagjen e epërme. Një tjetër terren sportiv që ndërlidhet me fushën e arsimit është gati në fshatin Dobidol dhe besoj që javën e ardhshme do ta inaugurojmë. Gjithmonë jemi munduar që projektet t'i realizojmë në atë mënyrë, që t'i japim hapësirë bashkëjetesës së përbashkët. Te shëndetësia kemi një projekt që realizohet së bashku me UNICEF-in dhe “Balkan sunflowers”, së bashku me QKMF-në ekipe speciale së bashku me një facilitator nga radhët e komuniteteve vizitojnë familjet e komuniteteve joshumicë, për mundësinë e imunizimit të rregullt për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë. Pika tjetër është kthimi i qëndrueshëm: Duke marrë parasysh që ZKKK ka një mision të veçantë për çështjet e kthimit dhe riatdhesimit, iniciacion procesin dhe i siguron kushtet për banim. Sa i përket kthimit të qëndrueshëm, për momentin nuk kemi raste që ka interferuar zyra jonë, sepse programi RR6 ende nuk e ka filluar funksionimin e tij dhe deri më tanë ende nuk e kemi një informatë se kur do të fillojë. Deri më tanë i kemi 4 raste që janë në pritje dhe në momentin e parë që aktivizohet programi vazhdon procesi. Në raport është edhe trajnimi i zyrtarëve mbi menaxhimin e data-bazës dhe sistemit për kthim të qëndrueshëm. Me nivelin qëndror e kemi një komunikim jokonstriktiv dhe zakonisht në çdo takim e paraqesim si problem. Mbështetja me start-up biznese vjen si mbështetje prej Ministrisë së Punëve të Brendshme për personat e riatdhesuar dhe shpeshherë edhe prej donatorëve të tjera, si është IOM-i. Në vitin e kaluar ne kemi aprovuar tri plane të veprimit: Për kthim të qëndrueshëm, për riatdhesim dhe për komunitetet Rom dhe Ashkali. Kur flasim për siguri, deri më tanë nuk kemi pasur ndonjë reagim për gjendje jo të mirë në vendbanimet e komuniteteve, kryesisht është situatë e qetë dhe stabile. Kohë pas kohe kemi komunikim edhe me zyrtarë të KFOR-it, duke diskutuar për gjendjen në përgjithësi. Një projekt i rëndësishëm që ia vlen të theksohet, e them me modesti, është që për herë të parë ZKKK nga Komuna e Rahovecit ka iniciuar kolegjumin e zyrave komunale për komunitete dhe kthim, një instrument që do ta ketë efektin e vet. E thash paraprakisht që ky komunikim jo i mirë me Ministrinë për Komunitete dhe Kthim dhe me disa ministri tjera dhe që përmes këtij kolegjumi do ta kemi një zë më të fuqishëm, duke filluar nga ndryshimi i rregullore të ZKKK dhe vendosjen e një buxheti dinjitor për të gjitha zyret. Kemi diskrepancë në dallim prej komunave tjera. Në këtë rast, Komuna e Istogut nga 300.000€ të hyra, ndërsa komuna jonë ka 20.000 dhe ka komunë që nuk ka fare buxhet. Ne kemi realizuar edhe disa projekte që konsiderohet në rëndësishëm, duke filluar prej kompit multietnik “Diversiteti ynë - pasuria e vendit” që ka ndodhur për herë të parë, i financuar nga UNMIK-u në bashkëpunim me organizatën “Advancing Together” dhe komunën tonë. Për të vazhduar me eksposita të ndryshme si ka qenë “diversiteti gjyqësor” me financimim të

komisionerit për gjuhë janë realizuar aktivitete të artit pamor, si dhe një shfaqje teatrale. Një takim mjaft i rëndësishëm konsiderohet edhe takimi me ambasadën amerikane, ku kemi pasur mundësi të propozojmë projekte të ndryshme për Komunën e Rahovecit për komunitetin joshumicë. Të gjitha informatat janë të publikuara në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Rahovecit.

Kryesuesi: Faleminderit z.Lendrit për kontributin e dhënë! Nëse dikush dëshiron ta marrë fjalën?

Ramë Berisha: Përshëndetje për pjesëmarrësit, për përfaqësuesit nga shëndetësia dhe KFOR-in. Në mbledhjen paraprake dhe në këtë mbledhje shefi i zyrës për komunitete dhe kthim, Lendrit Qeli, foli për shumë gjëra të dobishme për shoqërinë kosovare dhe më gjérë. Foli për arsim, infrastrukturë, siguri, aktivitete kulturo-artistike dhe sportive. Dua të flas edhe për bujqësinë si degë ekonomike. Në një takim që e patëm para një muaji, ku temë diskutimi ka qenë klima. Gjatë bisedës e përmenda që, nëse është mundësia nga donacionet e jashtme të ofroni ndonjë buxhet për buqit që kryesisht jetojnë nga prodhimi dhe bujqësia. Kemi gjithashtu edhe dëme që vijnë nga natyra, siç është stuhia dhe breshëri, duke bërë dëme të mëdha. Mirë është ta kemi një buxhet komunal që për ato familje të dëmtuara t'i ofrojmë ndihmë eventuale.

5. Të ndryshme;

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! Dua të flas për një pikë që të plotësohet takimi me vizita në terren, ku jemi me këtë çështje dhe në cilat seanca do t'i realizojmë vizitat? Një pikë tjeter për diskutim është që e kam parë një kronikë që jë anëtar i komunitetit ka dalë në televizion, aty ka qenë edhe Lendriti. Besoj që është detyrë e jona që t'i dalim në ndihmë. Çështja e tij është që i ka 6 ose 7 fëmijë dhe disa prej tyre nuk ka pasur mundësi t'i regjistrojë në gjendjen civile, sepse bashkëshortja e tij nuk ka qenë e regjistruar fare. Deri ku ka arritur kjo çështje?

Kryesuesi: Faleminderit! Rreth vizitave që janë realizuar gjatë këtij viti, nuk e di a keni qenë pjesëmarrëse në vizitën e fundit, kemi qenë në shkollën fillore "Gëzim Hamza – Piktori", aty jemi njoftuar rreth procesit mësimor të komunitetit joshumicë.

Lendrit Qeli: Sa i përket rastit të z. Fadil Gashi nga Kramoviku, ne si zyrë pothuajse ka 3 vite që jemi duke u marrë me çështjen e tij. Rasti është i komplikuar. Fillimi isht ka ndërrim të deklaratave, në fillim është thënë që shoqja e tij nga Mali i Zi ka ardhur ilegalisht në Kosovë. Në Mal të Zi ka lindur në shtëpi dhe as atje nuk ka pasur regjistrim përvete. Në momentin që ka ardhur në Kosovë, situata është komplikuar edhe më shumë, sepse ka bërë fëmijë të tjerë dhe fëmijët nuk kanë mundur të regjistrohen kur nënën nuk e kanë të regjistruar. Ne e kemi vizituar familjen së bashku me pjesëtarë të organizatës CRPK, e cila ka një mision të posaçëm për regjistrim civil, duke e trajtuar procesin edhe medialisht. Në fund, nëna ka arritur të regjistrohet personalisht, si dhe pas regjistrimit të vetes, gjithashtu ka arritur t'i regjistroj edhe dy fëmijët e fundit të saj, pjesa tjeter e fëmijëve ende është në proces. Duhet ta kemi të qartë që procesi është i gjatë, sepse duhet t'i kalojë proceset gjyqësore dhe jemi duke pritur që ditëve në vazhdim të marrim një raport nga organizata CRPK, e cila është e angazhuar ekskluzivisht me këtë rast. Sipas informacioneve, kanë mbetur edhe 3 anëtarë për t'u regjistruar, në mënyrë që kjo familje të kompletohet.

Ardian Rama: Faktikisht, meqë si pikë të rendit të ditës e kemi edhe ndihmën e komuniteteve, ne si drejtori mund t'i ndihmojmë familjes në fjalë me ndihmë momentale.

Kryesuesi: Ju falënderoj shumë për kontributin! Nëse nuk ka dikush diçka tjeter, mbledhja përfundoi këtu.

Mbledhja përfundoi: 11:00

Procesmbajtësi;


Albion Krasniqi



Kryesuesi i mbledhjes;

Bajram Morina